HEI'25
Higher Education Intervention 2025

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim



RAPORT I MONITORIMIT TË QENDRËS KOMBËTARE PËR NJOHJE DHE INFORMIM AKADEMIK

JANAR – DHJETOR 2022

Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6
Prishtina, 10000, Kosova

Autore:
Liridona Ademaj

Prishtinë, nëntor 2023

“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!»

[Faik Konica]

PËRMBAJTJA

DEFINIME 5
LISTË E SHKURTESAVE 6
HYRJE 7
PROCEDURAT E NJOHJES DHE LEGJISLACIONI 8
MIRATIMI I RREGULLORES PËR KËSHILLIN SHTETËROR PËR NJOHJE 9
VENDIMET NGA QENDRA KOMBËTARE PËR NJOHJE
DHE INFORMIM AKADEMIK 10
DIPLOMA PA VENDIM PËR NJOHJE APO MOSNJOHJE 16
VERIFIKIMI I DIPLOMAVE KOSOVARE NË QKNJIA 17
SFIDAT E QENDRËS KOMBËTARE PËR NJOHJE DHE INFORMIM AKADEMIK 19
- STAF I PAMJAFTUESHËM 19
- DATABAZA ONLINE 19
- DATABAZA INTERAKTIVE 20
- MOSANËTARËSIMI I QKNJIA NË RRJETIN ENIC 20
- EMËRIMI I ANËTARES PA DOKTORATË NË KËSHILLIN SHTETËROR PËR NJOHJE 20
- DIPLOMAT PEZULL NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË SHQIPËRI 21
- MUNGESA E NJË LIGJI TË VEÇANTË PËR QKNJIA 21
- PADITË GJYQËSORE PËR MOSNJOHJE TË DIPLOMAVE 22
- DIPLOMAT VENDORE TË MBETURA PA VERIFIKIM 23
- METODOLOGJIA E PUNËS SË KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN E DIPLOMAVE TË MBETURA 24
- DIPLOMA TË LËSHUARA NGA UNIVERSITETET PUBLIKE TË CILAT NUK ISHIN VERIFIKUAR ME VITE 25
- DIPLOMAT E FITUARA NË KOLEGJE PRIVATE QË NUK JANË VERIFIKUAR NDËR VITE 25

PËRFUNDIME 27

DEFINIME

- **NJOHJE** – do të thotë një pranim zyrtar nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë (MAShTI), i një diplome të fituar jashtë vendit, e cila e konfirmon saktësinë dhe vërtetësinë e saj.
- **BARASVLERË** – do të thotë një pranim zyrtar nga ana e MAShTI-it i një diplome të fituar jashtë vendit, e cila e konfirmon saktësinë dhe vërtetësinë e saj dhe bën krahasueshmërinë me nivelin e diplomave dhe fushës studimore përkatëse në vend.
- **VERIFIKIM** – Vlefshmëria e diplomës vërteton ekuivalencën e kredive dhe të diplomës së çdo certifikimi të fituar në cilindo nga institucionet e akredituara në Kosovë, që mbajnë një akreditim ekuivalent. Ky shërbim i certifikimit të diplomës ka për qëllim lehtësimin e pranimit jashtë Kosovës të diplomave dhe kredive të fituara nga institucionet e akredituara brenda Kosovës.
- **QENDRA KOMBËTARE PËR NJOHJE DHE INFORMIM AKADEMIK (QKNJIA)** - përbëhet nga Zyra e Qendrës dhe Këshilli Shtetëror për Njohje dhe ofron informacion në procedurat për njohjen e diplomave dhe kualifikimeve të huaja, si dhe ofron informata për sistemin e arsimit të lartë dhe kualifikimet në Kosovë me kërkesë të shteteve të tjera.
- **KËSHILLI SHTETËROR PËR NJOHJE (KShNj)** – është organ i cili merr vendime për njohje/barasvlerë apo mosnjohje/mosbarasvlerë, duke u bazuar në dosjen e parashtruesit të kërkesës dhe raportin e përgatitur nga zyrtari i Qendrës dhe në raste të veçanta, bazuar në rekomandimin e komisionit të ekspertëve. Përbëhet nga profesorë universitar të fushave të ndryshme studimore.

LISTË E SHKURTESAVE

- **MASHTI** – Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë
- **QKNJIA** - Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik
- **ENIC** – Rrjeti Evropian i Qendrave të Informimit
- **KShNj** - Këshilli Shtetëror për Njohje
- **MAS** - Ministria e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri
- **Niveli 5** – Shkollë e lartë profesionale
- **BA** – Niveli i studimeve themelore Baçelor i Arteve
- **BSc** – Niveli i studimeve themelore Baçelor i Shkencës
- **MA** – Niveli i studimeve Master i Arteve
- **MSc** – Niveli i studimeve Master i Shkencës
- **PhD** – Niveli i studimeve të doktoratës
- **ORCA** – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

HYRJE

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (tutje QKNJIA) është një nga institucionet kyçe të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Të gjithë personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, dhe duan të nisin punën në arsim të lartë në Kosovë, në pozitë profesoriale, e cila po ashtu lidhet me akreditim, duhet të kalojnë së pari procesin e njohjes së diplomave në QKNJIA. Kur fusim këtu universitete në rajon, të cilat kanë telashe me cilësi, QKNJIA bëhet gardiani i parë kundër diplomave jo-cilësore dhe potencialisht false, duke mbrojtur kështu arsimin e lartë.

NARIC Kosova vazhdon të përballet me sfida të ndryshme gjatë proceseve të punës së saj, për të cilat nuk po punohet për përmirësimin e gjendjes së tyre nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
Është evidentuar një numër i lartë i studentëve që kanë përfunduar apo që janë ende në studime e të cilët kanë probleme sa i përket njohjes së diplomave të tyre, për të cilat nevojitet një zgjidhje përfundimtare nga ana e Ministrisë së Arsimit.

Ky raport është rezultat i monitorimit të punës së Këshillit Shtetëror për Njohje (KShNj) në kuadër të Qendrës Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (QKNJIA), për periudhën janar- dhjetor të vitit 2022.

ORCA ka qenë e pranishme në të gjitha mbledhjet e mbajtura nga KShNj, si dhe ka mbajtur takime të vazhdueshme me stafin e Zyrës së QKNJIA, bashkë me të cilët edhe është bërë evidentimi i sfidave me të cilat vazhdojnë të përballen gjatë realizimit të punës së tyre.
Në këtë raport janë përfshirë të dhëna edhe rreth punës së Komisionit për Verifikimin e Diplomave të Fituara në Institucione të Arsimit të Lartë në Kosovë, i themeluar nga ana e Ministrisë së Arsimit në nëntor të vitit 2021.
Raport të natyrës së njëjtë për këtë institucion, ORCA ka publikuar edhe në mars të vitit 2022[1], në nëntor të vitit 2020[2] dhe në shkurt të vitit 2020[3].

1 "Raport i monitorimit të Qendrës Kombëtare për Njohje të Diplomave (NARIC KOSOVA) 3", mars 2022, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2022/03/RAPORTI-I-MONITORIMIT-TE-NARIC-KOSOVA-3.pdf

2 Raport i monitorimit të NARIC KOSOVA 2, nëntor 2020, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/11/RAPORTI-I-MONITORIMIT-TE-NARIC-KOSOVA-2.pdf

3 Raport i monitorimit të NARIC KOSOVA, shkurt 2020, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/RAPORTI-I-MONITORIMIT-T%C3%8B-NARIC-KOSOVA-ALB-03.pdf

PROCEDURAT E NJOHJES DHE LEGJISLACIONI

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (QKNJIA) aktualisht vepron duke u bazuar në legjislacionin në fuqi si më poshtë:

- *Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës*[4]
- *Udhëzimin Administrativ për verifikimin e dokumentacionit shkollor (Publik dhe privat) për nevojat e kandidatëve që shkollohen jashtë shtetit*[5],
- *Udhëzimin Administrativ për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës*[6].
- *Rregullorja e punës së Këshillit Shtetëror për Njohje dhe Komisioneve nga Fushat Përkatëse*

Diplomat e fituara në universitete publike të rajonit dhe në universitete që gjenden në listat e rangimeve botërore si në Academic Ranking of World Universities (ARWU), Times Higher Education World University Ranking (THE) dhe QS World University Ranking, pasi arrijnë të konfirmohen nga shteti përkatës se janë autentike dhe të vlefshme, miratohen nga QKNJIA pa kaluar nëpër Këshillin Shtetëror për Njohje.

Këshilli Shtetëror për Njohje, konkretisht anëtari i fushës së studimit prej të cilës është fituar diploma shqyrton fillimisht aplikimin për njohje të diplomës mirëpo në rast të ndonjë paqartësie ai aplikim diskutohet edhe me anëtarët e tjerë të këshillit, në të kundërtën pas shqyrtimit nënshkruhet nga anëtari i fushës përkatëse dhe aplikuesi pranon vendimin nga QKNJIA se diploma i është njohur.

4 Ligji për Arsimin e Lartë, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761

5 Udhëzimi Administrativ për Verifikimin e Dokumentacionit Shkollor (Publik dhe privat) për Nevojat e Kandidatëve që Shkollohen Jashtë Shtetit, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10210

6 Udhëzimi administrativ për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës, linku, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15228

QKNjIA, kërkon informacion pranë qendrave të rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC – NARIC), mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë, vlefshmërinë e diplomave apo certifikatave, nivelin e tyre sipas Kornizës Kombëtare/Evropiane të Kualifikimeve, si dhe informacione tjera shtesë në funksion të njohjes/barasvlerës të diplomës.

Aplikimi për njohje të kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës është i mundur përmes ueb faqes[7] së kësaj qendre.

Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të kalojnë përmes procesit të njohjes nga ana e Ministrisë së Arsimit për të konfirmuar saktësinë dhe vërtetësinë e saj, ndërsa diplomat e fituara brenda vendit duhet të kalojnë nëpër procesin e verifikimit për të vërtetuar vlefshmërinë e diplomës dhe ekuivalencën e kredive në mënyrë që të lehtësohet pranimit i këtyre diplomave jashtë Kosovës.

MIRATIMI I RREGULLORES PËR KËSHILLIN SHTETËROR PËR NJOHJE

Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj), në dhjetor të vitit 2022 ka miratuar Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror për Njohje dhe Komisioneve nga Fushat Profesionale përmes të cilës po funksionojnë këto dy lloje trupash vendimmarrëse brenda Qendrës Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (QKNJIA).

Krijimi i një rregulloreje të tillë, është mundësuar përmes ndihmës së ekspertëve të caktuar të angazhuar nga projekti QAINT i mundësuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), në konsultim me disa prej anëtarëve të KSHNJ-së dhe të stafit të qendrës.

Nga dhjetori i vitit 2022, Këshilli ka filluar të punojë duke u bazuar edhe në këtë rregullore, përveç Udhëzimit Administrativ 12/2018 për Parimet dhe

7 Faqja e Qendrës Kombëtare për Njohje të Diplomave: https://naric-ks.online/

Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës.

VENDIMET NGA QENDRA KOMBËTARE PËR NJOHJE DHE INFORMIM AKADEMIK

Gjatë periudhës kohore janar-dhjetor të vitit 2022, janë marrë gjithsej 1 mijë e 132 vendime nga Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj) në Qendrën Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (QKNJIA). Vendimet janë edhe për rastet që kanë ardhur si kërkesa edhe gjatë viteve paraprake por që nuk kanë arritur të marrin njohje për arsye të vonesave të ndryshme në sigurimin e informatave të nevojshme për njohje të diplomave.


Ndërkohë në proces janë 240 diploma të cilave ende nuk u është dhënë përgjigje nga Qendra për Njohje të Diplomave si pasojë e mungesës së përgjigjeve zyrtare nga institucionet ku palët i kanë përfunduar studimet, apo nga qendrat e shteteve përkatëse.

Për krahasim, në periudhën kohore janar-dhjetor të vitit 2021, ishin marrë gjithsej 1 mijë e 95 vendime nga Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik, ndërkohë që në proces ishin 203 diploma të cilave nuk u ishte dhënë ende përgjigje rreth njohjes për shkak të mungesës së përgjigjeve nga institucionet ku palët i kishin përfunduar studimet, apo nga qendrat e shteteve përkatëse.

Numri i kërkesave për njohje/barasvlerë të diplomave të arsimit të lartë ishte gjithsej 779 gjatë vitit 2022. Diplomat ishin njohur nga shtete të ndryshme, siç janë Maqedonia e Veriut me 278 diploma, nga Shqipëria me 200 diploma, Turqia me 122 diploma, nga Mbretëria e Bashkuar me 28 diploma, Shtetet e Bashkuara të Amerikës me 25 diploma, nga Gjermania me 13 diploma, Kroacia me 10 diploma, nga Greqia me 6 diploma, Bosnjë


dhe Hercegovina me 13 diploma, nga Austria me 8 diploma, Suedia me 4 diploma, nga Zvicra me 6 diploma, Arabia Saudite me 6 diploma, nga Franca me 12 diploma, Hungaria me 6 diploma, nga Belgjika me 3 diploma, Jordania me 6 diploma, nga Mali i zi me 6 diploma, Holanda me 6 diploma, nga Sllovenia me 4 diploma, Norvegjia me 3 diploma, nga Finlanda me 1 diplomë dhe Bullgaria me 13 diploma.

Numri i Diploma të Njohura në 2022 Sipas Shteteve të Diplomimit



Kërkesat për njohje të diplomave gjatë vitit 2022 ishin nga fusha të ndryshme mirëpo dominonte fusha e shkencave mjekësore dhe të sportit me 210 diploma, më pas nga fusha e shkencave sociale, të edukimit dhe ato humane me 139 diploma, duke vazhduar me fushën e shkencave ekonomike me 102 diploma. Tutje ishte fusha e shkencave juridike me 85 diploma, fusha e shkencave linguistike me 74 diploma, fusha e shkencave inxhinierike me 53 diploma, fusha e shkencave të mjedisit, natyrore dhe matematikore me 51 diploma, fusha e shkencave artistike me 25 diploma, fusha e shkencave bujqësore dhe të veterinës me 15 diploma, fusha e shkencave të arkitekturës dhe planifikimit me 14 diploma dhe fusha e shkencave të studimeve islame me 11 diploma.

Përqindja e Diplomave të Njohura në 2022 Sipas Fushave të Studimit



- **Shkencat mjekësore dhe sportit**
- **Shkencat sociale, edukimit, humane**
- **Shkencat ekonomike**
- **Shkencat juridike**
- **Shkencat linguistike**
- **Shkencat inxhinierike**
- **Shkencat e mjedisit, natyrore dhe matematikore**
- **Shkencat artistike**
- **Shkencat bujqësore dhe veterinës**
- **Shkencat e arkitekturës dhe planifikimit**
- **Shkencat e studimeve islame**

Sipas Udhëzimit Administrativ për procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare te fituara jashtë Republikës së Kosovës, koha e paraparë për njohje të një diplome është nga 1 deri në 4 muaj. Mirëpo sipas praktikës, i gjithë procesi nuk zgjatë më shumë se 2 muaj.

Sipas zyrtarëve në QKNJIA, vonesa mund të ketë në rastet kur diplomat vijnë nga institucionet private, e veçanërisht ato të rajonit, kur ka vonesa në përgjigje nga ana e institucioneve relevante apo kur përgjigjja e tyre nuk përfshinë informatat e plota, siç janë informatat në lidhje me akreditimin dhe vlefshmërinë e atyre diplomave. Raste të tjera të vonesave, kishte edhe nga vendet që nuk e kanë njohur Kosovën andaj autoritetet e atij vendi nuk i përgjigjen kërkesave të QKNJIA për verifikimin e vlefshmërisë së diplomave. Në këto raste, QKNJIA tenton të marr informata përmes notës verbale apo shërbimit diplomatik, por edhe nga qendrat e vendeve të BE-së.

Gjatë vitit 2022, Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj) ka vendosur për njohjen apo mosnjohjen e diplomave të fituara në Institucione të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat jashtë Republikës së Kosovës.

Këshilli Shtetëror për Njohje (KShNj) ka mbajtur gjithsej njëmbëdhjetë (11) mbledhje; me 21 janar, 22 shkurt, 4 mars, 15 prill, 31 maj, 23 qershor, 22 korrik, 22 shtator, 20 tetor, 25 nëntor dhe 16 dhjetor përmes të cilave janë marr 1 mijë e 132 vendime rreth njohjes apo mosnjohjes së diplomave.

KShNj ka marrë vendime pozitive për 1 mijë e 106 lëndë, 23 të nivelit të pestë, 291 të nivelit Baçelor, 553 të nivelit Master dhe 239 të nivelit të doktoratës.

Vendim negativ kanë dhënë për 16 diploma të nivelit Baçelor dhe 10 të nivelit Master.

Në janar, KShNj ka njohur katër (4) diploma të nivelit 5, pesëmbëdhjetë (15) diploma të nivelit Baçelor, tridhjetë e një (31) të nivelit Master dhe trembëdhjetë (13) të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 63 diploma, ndërkaq nuk e kanë njohur një diplomë të nivelit Baçelor.

Në muajin shkurt, janë njohur shtatë (7) diploma të nivelit 5 nga KShNj, 40 diploma të nivelit Baçelor, 70 të nivelit Master dhe 26 të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 143 diploma në këtë periudhë, ndërsa nuk kanë njohur një diplomë të nivelit Baçelor dhe dy të nivelit Master.
Në mars, KShNj ka njohur gjithsej pesëmbëdhjetë (15) diploma të nivelit Baçelor, njëzet e pesë (25) diploma të nivelit Master dhe shtatëmbëdhjetë (17) të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 57 diploma.

Në muajin prill, KShNj njohu 2 diploma të nivelit 5, 14 të nivelit Baçelor, 27 diploma të nivelit Master dhe 9 të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 52 diploma.
Në maj, KShNj ka njohur 42 diploma të nivelit Baçelor, 86 diploma të nivelit Master dhe 36 diploma të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 164 diploma, ndërkaq nuk e kanë njohur një diplomë të nivelit Baçelor.

Ndërkaq në muajin qershor, KShNj ka njohur tri diploma të nivelit të 5, 28 diploma të nivelit Baçelor, 52 diploma të nivelit Master dhe 30 diploma të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 113 diploma, ndërkaq nuk i kanë njohur 9 diploma të nivelit Baçelor dhe 8 të nivelit Master.

Gjatë muajit korrik, KShNj ka njohur 17 diploma të nivelit Baçelor, 27 të nivelit Master dhe 11 të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 55 diploma.
Në gusht, KShNj ka njohur 11 diploma të nivelit Baçelor, 29 të nivelit Master dhe 15 diploma të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 55 diploma.

Në muajin shtator, KShNj ka njohur 1 diplomë të nivelit 5, 24 të nivelit Baçelor, 30 diploma të nivelit Master dhe 10 diploma të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 65 diploma, ndërkaq nuk janë njohur dy diploma të nivelit Baçelor.

Në tetor, KShNj ka njohur dy diploma të nivelit të 5, 13 të nivelit Baçelor, 40 diploma të nivelit Master dhe 22 diploma të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 77 diploma.
Në muajin nëntor, KShNj ka njohur 1 diplomë të nivelit të 5, 29 diploma të nivelit Baçelor, 67 diploma të nivelit Master dhe 23 diploma të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 120 diploma, ndërkaq nuk e kanë njohur një diplomë të nivelit Baçelor.

Ndërkaq në dhjetor, KShNj ka njohur 3 diploma të nivelit të 5, 43 diploma të nivelit Baçelor, 69 diploma të nivelit Master dhe 27 diploma të nivelit të doktoratës. Gjithsej janë njohur 142 diploma, ndërkaq nuk e kanë njohur një diplomë të nivelit Master.

Për krahasim, në raportin e kaluar me të dhëna për vitin 2021, Këshilli Shtetëror për Njohje kishte marrë vendime pozitive apo kishte njohur 560 diploma, prej të cilave 16 ishin të nivelit të pestë, 174 të nivelit Baçelor, 241 të nivelit Master dhe 129 të nivelit të doktoratës. Ndërkohë që vendime negative apo mosnjohje kishte pasur për 9 diploma të nivelit të 5.

PASQYRË E VENDIMEVE TË KËSHILLIT SHTETËROR PËR NJOHJE GJATË 2022

JANAR	POZITIV	NEGATIV
Niveli 5	4	
Baçelor	15	1
Master	31	
PhD	13	
Total	63	1

SHKURT	POZITIV	NEGATIV
Niveli 5	7	
Baçelor	40	1
Master	70	2
PhD	26	
Total	143	3

MARS	POZITIV	NEGATIV
Niveli 5		
Baçelor	15	
Master	25	
PhD	17	
Total	57	

PRILL	POZITIV	NEGATIV
Niveli 5	2	
Baçelor	14	
Master	27	
PhD	9	
Total	52	

MAJ	POZITIV	NEGATIV
Niveli 5		
Baçelor	42	1
Master	86	
PhD	36	
Total	164	1

QERSHOR	POZITIV	NEGATIV
Niveli 5	3	
Baçelor	28	9
Master	52	8
PhD	30	
Total	113	17

KORRIK	POZITIV	NEGATIV
Niveli 5		
Baçelor	17	
Master	27	
PhD	11	
Total	55	

GUSHT	POZITIV	NEGATIV
Niveli 5		
Baçelor	11	
Master	29	
PhD	15	
Total	55	

SHTATOR	POZITIV	NEGATIV
Niveli 5	1	
Baçelor	24	2
Master	30	
PhD	10	
Total	65	2

TETOR	POZITIV	NEGATIV
Niveli 5	2	
Baçelor	13	
Master	40	
PhD	22	
Total	77	

NËNTOR	POZITIV	NEGATIV
Niveli 5	1	
Baçelor	29	1
Master	67	
PhD	23	
Total	120	1

DHJETOR	POZITIV	NEGATIV
Niveli 5	3	
Baçelor	43	1
Master	69	
PhD	27	
Total	142	1

Totali i përgjithshëm: 1,132

DIPLOMA PA VENDIM PËR NJOHJE APO MOSNJOHJE

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (QKNJIA), për periudhën janar-dhjetor 2022 ka gjithsej 240 diploma të cilat ende gjenden në proces të njohjes dhe për të cilat nuk është dhënë një vendim për njohje apo mosnjohje.

Numri i këtyre diplomave që ende u mungon një përgjigje, e të cilat vijnë nga shteti i Shqipërisë është 38, nga shteti i Maqedonisë së Veriut janë 66 diploma, ndërkaq numri i përgjithshëm i lëndëve pa përgjigje nga vendet e tjera është 136.
Arsyet që këto diploma kanë mbetur pa një vendim për njohje apo mosnjohje nga QKNJIA, mbesin të ngjashme me ato në raportet e kaluara të publikuara nga ne e të cilat ishin si më poshtë:

Nuk ka përgjigje nga institucionet ku kandidatët i kanë përfunduar studimet; *Nuk ka informacion lidhur me akreditimin e programit apo institucionit dhe QKNJIA është në pritje të përgjigjes për akreditim*; *Diplomat vijnë nga institucione të shteteve që nuk e njohin Kosovën si shtet*; *Vonesat në përgjigje nga institucionet e Turqisë*; *Përgjigje të paqarta rreth vlefshmërisë së diplomës nga institucionet e Shqipërisë*; e të tjera.

Për krahasim, në raportin e kaluar të vitit 2021, ishin gjithsej 203 diploma të cilat ende nuk kishin marrë një përgjigje nga QKNJIA për njohje apo mosnjohje.

Numri i diplomave që ishin pa një përgjigje, e të cilat vinin nga shteti i Shqipërisë ishte 75, nga shteti i Maqedonisë së Veriut ishin 48 diploma, ndërkaq numri i përgjithshëm i lëndëve pa përgjigje nga vendet e tjera ishte 80.



VERIFIKIMI I DIPLOMAVE KOSOVARE NË QKNJIA

Sipas të dhënave të grumbulluara nga kjo qendër gjatë vitit 2022, komponenta e verifikimit të diplomave të fituara brenda Kosovës me qëllim të përdorimit të tyre jashtë vendit ka arritur gjithsej në 4 mijë e 32.

Nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe nga institucionet e arsimit të lartë privat janë verifikuar diploma në muajt si në vijim.


Në muajin janar janë verifikuar 327 diploma, në muajin shkurt 316, në muajin mars janë verifikuar 265 diploma, në muajin prill 252, në muajin maj janë verifikuar gjithsej 315 diploma.

Në qershor të vitit 2022, janë verifikuar 320 diploma, në korrik 387, në muajin gusht janë verifikuar 306 diploma, në muajin shtator janë verifikuar gjithsej 410 diploma.

Në muajin tetor janë verifikuar 377 diploma, në muajin nëntor 345 ndërsa në muajin dhjetor janë verifikuar gjithsej 412 diploma.

QKNJIA ende nuk e ka krijuar një rubrikë të veçantë përmes të cilës palët mund të deklarohen se për çfarë arsye po e bëjnë verifikimin e diplomës, mirëpo sipas QKNJIA, në të shumtën e rasteve palët janë vetdeklaruar për motivin e kërkesës për verifikim të diplomës dhe shumica prej tyre, kanë treguar se këtë po e bëjnë për të shkuar jashtë vendit për vazhdim të studimeve apo për të kërkuar një punë jashtë Kosovës.

VERIFIKIMI I DIPLOMAVE 2022



Totali: 4,032

SFIDAT E QENDRËS KOMBËTARE PËR NJOHJE DHE INFORMIM AKADEMIK

STAF I PAMJAFTUESHËM

QKNJIA vazhdon të përballet me mungesë të dukshme të stafit përmes të cilëve do të bëhej shpërndarja e shqyrtimit të lëndëve mes zyrtarëve. Kjo sfidë vazhdon të jetë aktuale për shkak të pamundësisë së rekrutimit si pasojë e mungesës së riorganizimit të një organogrami nga Ministria e Arsimit dhe divizioneve brenda saj, e cila thuhet se ende është në proces e sipër.

Rekrutimi i përkohshëm i kontraktorëve/konsulentëve individual ende bëhet përmes platformës e-prokurimi dhe 70 për qind të shërbimeve apo aktiviteteve të kësaj qendre kryhen përmes tyre. Shpesh ndodhë që kjo qendër të mbesë me vetëm një zyrtar për Arsim të Lartë dhe një për Arsim Parauniversitar si pasojë e përfundimit të kontratave të konsulentëve individual pavarësisht volumit të madh të punës dhe kërkesave që vijnë. Propozohet sërish që për këtë qendër, të ketë mbështetje me staf profesional permanent apo të gjendet një zgjidhje për kohë të caktuar siç është angazhimi i konsulentëve me përvojë relevante.

DATABAZA ONLINE

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (QKNJIA) vazhdon të funksionojë pa një databazë digjitale të mirëfilltë. Prej vitit 2021, QKNJIA posedon një platformë online për aplikim për njohje/barasvlerë të diplomave, përmes së cilës palët kanë qasje në informata rreth aplikimit. Ata gjithashtu pajisen me një kod përmes të cilit informohen për fazën në të cilën gjendet aplikimi i tyre. Mirëpo, QKNJIA duhet të plotësohet me një platformë që posedon edhe komponentin e verifikimit/validimit të diplomave për përdorim jashtë vendit.

Që nga shtatori i vitit 2018, QKNJIA ishte duke funksionuar pa një databazë online, e cila do të përmbante të dhëna për të gjitha lëndët që kanë pranuar, ato të cilat janë në proces dhe për ato që i kanë shqyrtuar. Zyrtarët

në QKNJIA detyrohen që për çfarëdo informacioni, kërkimin ta bëjnë në mënyrë fizike mes dokumenteve në arkiv. Andaj, përsëri propozohet krijimi i një databaze digjitale, e cila do të mundësonte ruajtjen/arkivimin e të dhënave për njohjet/barasvlerën apo verifikimin/validimin e diplomave ndër vite.

DATABAZA INTERAKTIVE

Një databazë e tillë do të shërbente për shtetet e tjera, të cilat kanë nevojë për informata rreth sistemit të arsimit në Kosovë. Ajo gjithashtu do t'ua lehtësonte procedurat studentëve kosovarë të cilët për arsye të ndryshme, i përdorin diplomat e tyre jashtë vendit. Kjo qendër ende nuk posedon as databazë për sistemin e arsimit parauniversitar dhe të lartë në Kosovë, të cilat do të duhej të publikoheshin në ueb të QKNJIA-së.

MOSANËTARËSIMI I QKNJIA NË RRJETIN ENIC

Deri tani Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (QKNJIA) ka qasje të kufizuar rreth institucioneve dhe programeve sa i përket informatave që i duhet grumbulluar për të njohur diplomat e fituara në shtete të ndryshme të botës. Dhe kjo është si pasojë e mosanëtarësimit të QKNJIA në rrjetin evropian të qendrave të informimit- ENIC. Kjo ndodhë si pasojë e asaj që Kosova ende nuk është pjesë e Këshillit të Evropës dhe UNESCO-s, për të cilin është i obligueshëm anëtarësimi edhe në këto organe.

EMËRIMI I ANËTARES PA DOKTORATË NË KËSHILLIN SHTETËROR PËR NJOHJE

Në mars të vitit 2022, Ministria e Arsimit emëroi znj. Ajshe Bytyqi në pozitën e anëtares së Këshillit Shtetëror për Njohje për të mbuluar fushën e Ekonomisë sa i përket kërkesave për njohje të doktoratës së kandidatëve që kanë përfunduar studimet jashtë Kosovës.

Sipas Udhëzimit Administrativ për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale

dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës[8], në Nenin 5, i cili flet për Këshillin Shtetëror për Njohje në pikën 2 thuhet se anëtarët profesional duhet të jenë me përvojë relevante në çështje të arsimit të lartë.

Ndërkaq anëtarja e re, është e diplomuar vetëm në nivelin Bachelor dhe gjatë diskutimit në takimin e parë në këtë këshill, kishte deklaruar se nuk ka përvojë pune në arsimin e lartë. Bazuar në këto dy fakte, mund të konsiderohet si e papërshtatshme që vlerësimi i doktoratave të kandidatëve të ndryshëm të bëhet nga një anëtare e cila kualifikimin e vetëm e ka atë Bachelor dhe nuk ka përvojë relevante në arsimin e lartë.

DIPLOMAT PEZULL NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË SHQIPËRI

Ka vite që Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik në Kosovë, ka vonesa në kthimin e një përgjigjeje palëve apo në njohjen e diplomave të tyre të fituara në Republikën e Shqipërisë. Ky problem vazhdon të mbetet aktual si pasojë e përgjigjeve kontradiktore të institucioneve relevante atje për diplomat e fituara në universitetet private në Shqipëri, kjo është më e theksuar tek rastet e diplomave të fituara në ato institucione që tashmë veç janë të mbyllura.
Për diplomat e fituara në ish-universitetin Kristal, KSHNj merr vendime negative sa i përket njohjes së tyre meqenëse edhe vetë Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) në Shqipëri, këto diploma nuk i konsideron të vlefshme. Ndërkaq sa i përket diplomave të fituara në kolegje të tjera private atje, vendimet variojnë nga rasti në rast.

MUNGESA E NJË LIGJI TË VEÇANTË PËR QKNJIA

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (QKNJIA) ende funksionon pa një ligj të veçantë i cili rregullon specifikat e punës dhe vendimmarrjes sa i përket njohjes, verifikimit dhe barasvlerës së diplomave. Nga kjo qendër thonë se gjatë vitit 2023 do të iniciojnë koncept dokumentin i cili më pas duhet të zhvillohet në procedura të tjera nëse mbështetet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

Mungesa e një ligji të tillë, mbetet një ndër sfidat më të vështira për QKNJIA-në dhe kjo për arsye se tashmë ka raste në të cilat Gjykata ka obliguar Ministrinë e Arsimit, konkretisht Këshillin Shtetëror për Njohje (KShNj) dhe QKNJIA-në, që të zbatojë vendimin e saj për njohje të diplomave.

PADITË GJYQËSORE PËR MOSNJOHJE TË DIPLOMAVE

Gjatë vitit 2022, QKNJIA është përballë me padi në Gjykatë si pasojë e mosnjohjes së gradës 'Juris Doctor' (JD) si doktoratë e një kandidati. Rasti ishte kthyer në rishqyrtim përmes urdhrit të gjykatës dhe rekomandimit të Komisionit të Ankesave brenda Ministrisë së Arsimit, mirëpo Këshilli Shtetëror për Njohje vazhdon të qëndrojë prapa vendimit paraprak se kjo gradë nuk mund të barasvlerësohet me doktoratë.

> Grada Juris Doctor (JD), në Shtetet e Bashkuara të Amerikës njihet si gradë profesionale pas gradës Baçelor. (*Sistemi i Arsimit të Lartë në ShBA dallon nga ai në Evropë.*) b

Rasti ishte rishqyrtuar edhe nga ekspertë të fushës të cilët kanë vlerësuar se këto dy grada nuk mund të barasvlerësohen.

Raste të ngjashme kishte pasur edhe gjatë vitit 2021, kur QKNJIA dhe KSHNJ ishin përballë me Gjykatën Themelore në Prishtinë, pas vendimit negativ rreth barasvlerës së një diplome tjetër Juris Doctor me nivelin e tetë të studimeve, pra si doktoratë.
Organet kompetente për njohje të diplomave, QKNJIA dhe KSHNJ kishin refuzuar një aktvendim të tillë dhe janë ankuar në Gjykatën e Apelit.

Sipas kryesueses së Këshillit Shtetëror për Njohje, Kumrije Gagica, në rastin e përmendur më lartë Avokatura Shtetërore nuk ishte e pranishme në Gjykatë dhe udhëheqësja e NARIC-ut njëherësh edhe kryesuese e KShNj-së, ishte pa mbrojtës ligjor nga zyra ligjore e Ministrisë së Arsimit apo Avokatura e Shtetit. Shqetësuese mbetet mungesa Avokaturës së Shtetit në seanca gjyqësore në të cilat është e thirrur që të mbrojë institucionin, në këtë rast Ministrinë e Arsimit.

Qendra Kombëtare për Njohje të Diplomave është paditur edhe nga palë të tjera të cilët kanë marrë vendime negative për njohje të diplomave të fituara në universitete private në Shqipëri.

Shembull i tillë janë diplomat e fituara në ish-Universitetin Kristal meqenëse Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) në kuadër të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) nuk i konsideron të vlefshme diplomat e fituara në këtë institucion.

Ngjashëm qëndron situata edhe me diplomat e fituara në disa prej institucioneve private të arsimit të lartë, të cilat aktualisht janë të mbyllura dhe sipas QKNJIA, për këto padi kanë paraqitur dëshmitë e nevojshme para gjykatës për të argumentuar vendimet negative për mosnjohje të diplomave. Për raste të tilla, QKNJIA ende është në pritje të një vendimi përfundimtarë nga ana e gjykatës kompetente.

Mirëpo ka raste që diplomat e fituara në institucione private të arsimit të lartë në Shqipëri njihen, pra këto vendime dallojnë varësisht nga dokumentet dhe përgjigjet zyrtare të institucioneve relevante atje.

DIPLOMAT VENDORE TË MBETURA PA VERIFIKIM

Gjatë vitit 2022, ka vazhduar punën Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) në Kosovë, i cili ishte themeluar nga Ministria e Arsimit si pasojë e rritjes së rasteve të studentëve që ankoheshin se nuk po arrijnë t'i verifikojnë diplomat e tyre për shkak të parregullsive të ndryshme nga ana e institucioneve të arsimit të lartë, në zbatimin e akteve nënligjore për mbajtjen e librave amëz, siç janë tejkalimi i kuotës së studentëve që mund të regjistrojnë në programe studimore, regjistrimi i studentëve në programe që nuk kanë pasur akreditim, bartja e studentëve nga një program në tjetrin, e të tjera.
Ky komision, deri tani ka vendosur dhe vlerësuar se duhet t'iu verifikohen diplomat 11 mijë e 300 ish-studentëve të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.[9]

9 * Të dhënat në këtë raport nuk janë të dhëna përfundimtare të punës apo vendimeve të këtij komisioni, meqenëse kjo trupë

METODOLOGJIA E PUNËS SË KOMISIONIT PËR VERIFIKIMIN E DIPLOMAVE TË MBETURA

Komisioni kishte bërë ndarjen e rasteve në dy grupe që kanë probleme në verifikimin të diplomave;

1. Palët që nuk kanë arritur të validojnë diplomat e tyre si pasojë e lëshimeve kur kolegji/universiteti "me vetëdije" ka regjistruar studentë në programe të caktuara duke mos pasur akreditim institucional apo të programit, duke mos pasur licencë, kur IAL-të kanë tejkaluar kuotat për regjistrim që i përcakton Agjencia e Akreditimit (*p.sh në X kolegji/universiteti në programin Y janë përcaktuar 50 kuota, ndërkaq kolegji/universiteti i ka regjistruar 100 studentë*), kur është bërë bartja e studentëve nga një program në tjetrin brenda kolegjit/universitetit pa vetëdijen e studentëve (*p.sh studentët janë duke studiuar infermieri, ndërkaq në sistem figurojnë në psikologji*), etj. si dhe

2. Palët që kanë rënë pre e lëshimeve teknike, siç janë vonesa në dërgimin e Librit Amëz nga kolegji/universiteti në Ministri, apo edhe vonesa nga Ministria për t'i proceduar dhe regjistruar studentët në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë (SMIAL).

Sipas metodologjisë së punës, ky komision ka vendosur që për të gjitha rastet kur konstatohen shkeljet si në pikën 1 të paragrafit më lartë, diplomat të shpallen të pavlefshme.

Ndërkaq, për të gjitha rastet e pikës 2, kur konstatohet sipas inspektoratit të arsimit që studentët i kanë ndjekur ligjëratat, i janë nënshtruar provimeve, kanë dëshmi mbi fletëpagesat e semestrave, e të tjera, diplomat e tyre do të shpallen të vlefshme.

ende nuk ka pushuar së vepruari.

DIPLOMA TË LËSHUARA NGA UNIVERSITETET PUBLIKE TË CILAT NUK ISHIN VERIFIKUAR ME VITE

Ish-studentët e programeve të akredituara në degët e Universitetit të Prishtinës (Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan) ka vite që nuk kanë arritur t'i verifikojnë diplomat e tyre dhe kjo si pasojë e themelimit të universiteteve të tjera publike të cilat më pas diplomat i kanë lëshuar në emër të universitetit përkatës.

Bazuar në marrëveshjet mes universiteteve publike, për këtë lloj diplomash komisioni vendosi që ish-studentëve të këtyre programeve t'iu vulosen diplomat dhe bartja e vendimit të akreditimit të atyre programeve për në universitetet përkatëse të konsiderohet valide.

Në listat e dorëzuara nga universitetet publike, numri i studentëve që nuk u është vulosur diploma me vite është 9 mijë e 285.

Ndërkaq situatë më ndryshe e mosverifikimit të diplomave të lëshuara nga universitetet publike ishin edhe rastet kur universitetet në fjalë kishin hasur në probleme teknike për regjistrimin e studentëve në SMIAL, të viteve akademike 2017/18, 2018/19 dhe 2019/20.

Numri i ish-studentëve të këtyre viteve akademike që ky komision vendosi t'ua bëjë verifikimin apo vulosjen e diplomave të tyre, arrin në 4 mijë e 609.

DIPLOMAT E FITUARA NË KOLEGJE PRIVATE QË NUK JANË VERIFIKUAR NDËR VITE

Vitet e fundit ishte rritur numri i ish-studentëve në kolegje private në vendin tonë, që ankoheshin se nuk po arrijnë të bëjnë verifikimin e diplomës në Qendrën Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (QKNJIA).

Kjo ishte pamundësuar për arsye nga më të ndryshmet siç janë, programi ku studenti/ja kishte përfunduar studimet nuk ishte i akreditуar apo nuk kishte pasur akreditim institucional gjatë kohës së studimeve, të dhënat e

studentes/it nuk gjendeshin në Sistemin e Menaxhimit të Informatave për Arsimin e Lartë sepse institucioni kishte regjistruar më shumë studentë se sa ishte paraparë përmes vendimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, institucioni kishte bërë bartjen e studentëve nga një program në tjetrin pa i informuar ata, e shumë të tjera.

4 mijë e 678 studentëve që nuk kanë qenë të regjistruar në SMIAL dhe që kanë arritur të dëshmojnë për vijueshmërinë e studimeve, u është verifikuar diploma.

Ndërkaq numri i ish-studentëve për të cilët është vendosur që t'iu verifikohet diploma dhe të cilët kanë pasur probleme të arsyeve të ndryshme, është 6 mijë e 691.

Komisioni i emëruar për zgjidhjen e këtyre problemeve nuk ka trajtuar ankesat e ish-studentëve apo kolegjeve të cilat kishin punuar pa licencë, pa akreditim dhe ato që kishin tejkaluar kuotën e regjistrimit të studentëve për program të vendosur nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

PËRFUNDIME

Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik (QKNJIA), ka vite që po përballet me probleme të ndryshme të cilat po i pengojnë apo ngadalësojnë në verifikimin e diplomave të fituara brenda Kosovës si dhe sfida të tjera që po e pamundësojnë njohjen e diplomave të fituara jashtë vendit.

Mungesa e një ligji të veçantë që rregullon funksionimin efikas të kësaj qendre është një ndër mangësitë më të mëdha. Aktualisht QKNJIA nuk mund t'i mbrojë siç duhet vendimet e saj para ligjit dhe gjykatave, meqenëse puna e saj kryesisht është e rregulluar me udhëzim administrativ i cili në Gjykatë nuk peshon njëjtë si ligji.

Komisioni për Verifikimin e Diplomave ka vendosur t'i vulosë diplomat e 11 mijë e 300 ish-studentëve të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.

Për ish-studentët që nuk arritën t'i verifikojnë diplomat e tyre e që ishin viktima të mashtrimeve nga institucionet e arsimit të lartë, ende nuk ka filluar ndonjë proces gjyqësor për kompensimin e tyre, madje nuk është bërë as tërheqja e licencave të këtyre institucioneve nga ana e Ministrisë së Arsimit, pra nuk ka llogaridhënie për këto dështime nga asnjëra prej hallkave të përgjegjësisë institucionale.

Në ndërkohë kërkesat për verifikim të diplomave në Qendrën Kombëtare për Njohje të Diplomave me qëllim të përdorimit të tyre jashtë vendit tonë po vazhdojnë të rriten, e sipas zyrtarëve në QKNJIA në të shumtën e rasteve aplikantët deklarojnë se dokumenti iu nevojitet për shpërngulje nga Kosova.

Qendra për njohje dhe verifikim të diplomave ka numër të ulët të stafit apo zyrtarëve relevant për të kryer shërbimet që ofron kjo qendër.

Është i nevojshëm edhe krijimi dhe funksionalizimi i disa lloje të databazave që do të përmirësonin cilësinë e punës brenda qendrës dhe imazhin e saj

para publikut vendor dhe atij ndërkombëtarë, përmes publikimit të informatave të nevojshme për palët e interesuara për shërbime të ndryshme të cilat i ofron Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik. Këtu përfshihen edhe të dhëna për kërkesa për njohje të diplomave të ndara sipas titujve shkencor BA, MA apo PhD për të gjitha shtetet nga kanë ardhur këto diploma, kjo për të parë mundësinë e bërjes së politikave të veçanta për mbrojtjen e cilësisë në Kosovë, e cila mund të cenohet nga diploma fiktive ose të shteteve pa sigurim të mirëfilltë të cilësisë.

Deklaratë e mohimit të përgjegjësisë:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit "*Intervenimi në Arsimin e Lartë – HEI'25*". Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from

Austrian Development Cooperation

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku, Tehnologiju i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

KEC
Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim